



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGECIA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


Përgatitja e dokumentacionit gjeodezik dhe kadastral për ndërtesat dhe pjesët e ndërtesave në procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje

1. Rilevimi i objektit / ndërtesës - Situacioni

Rilevimi i objekteve bëhet duke matur minimum tri pika të dy brinjëve të gjata me instrumente për matje GNSS/Stacion Total, ndërsa pikat tjera duhet të krijohen duke matur frontet me distancë matës apo ndonjë metodë tjetër. Informacion shtesë për ndërtesa paraqitet si veçori edhe streha.

Në hartën (skicën) që përpilon gjeodeti apo kompania gjeodete e licencuar përveç objektit që trajtohet duhet të paraqiten edhe të dhënat si vijon:

- Streha
- Kyçja në rrjetin elektrik;
- Kyçja në rrjetin e ujësjellësit;
- Kyçja në rrjetin e ujërave të zeza;
- Pjesa e objekteve fqinje të cilat janë të ndërtuara afër kufirit të parcelës apo afër objektit të trajtuar;
- Rrethoja (muri, rrethojë metalike etj);
- Rrugët;
- Adresa e ndërtesës (emri i rrugës dhe numri i ndërtesës), e cila identifikohet nga Gjeoportali shtetëror;



Situacioni

2. Dëshmit nga gjeoportali dhe fotot e ndërtesës

Në procesin e legalizimit specifikohet që objektet që mund të trajtohen janë vetëm ato që janë të ndërtuara deri në 05 Shtator 2018, andaj dokumentacionit duhet ti bashkëngjitet edhe një skicë nga gjeoportali shtetëror, me të cilën dëshmohet që objekti është i paraqitur në ortofoto të vitit 2018.



Objekti ne parcelen 252-7

04.11.2019 13:59




Dëshmia nga gjeoportali

Gjate matjes gjeodeti duhet ti bej edhe fotot për ndërtesën, fotot duhet të bashkëngjiten në raportin / elaboratin i cili dorëzohet ne komunë.

3. Përgatitja e skicave për katet

Në rastet e ndërtesave të banimit duhet të përgatiten skicat për secilin kat, në të cilat duhet të paraqitet gabariti i katit, duke përfshirë edhe terasat. Në bazë të këtyre të dhënave do të llogaritet sipërfaqja e përgjithshme e ndërtesës.



Formati dhe përmbajtja e manualit për katet

Për secilin katë duhet të përgatitet lista e koordinatave që duhet të përmbajë: numrin e pikave, koordinatat Y, X dhe kuotën e bazës së pllakës të katit përkatës H si dhe sipërfaqen e katit.

Nr.	Y	X	H	Etazhi	Sipërfaqja (m ²)
B1	7511461.92	4720540.65	634.59	Bodrumi	58.82
B2	7511467.56	4720540.42			
B3	7511467.22	4720529.68			
B4	7511462.18	4720529.92			
B5	7511462.31	4720532.87			
B6	7511461.66	4720532.91			

Lista e koordinatave

4. Përgatitja e të dhënave për Kadastër

Pas përpunimit të të dhënave përgatitet manuali, formati dhe përmbajtja e manualit është sipas formatit zyrtar të përcaktuar në kornizën e punës së AKK-së numër 2019/01.

The image shows a form for a cadastral manual. At the top, there is a header with the logo of the Agency for Real Estate Cadastre of Kosovo and the text 'Agjencia Kadastrale e Kosovës'. Below this, there is a table with columns for 'Nr.', 'Y', 'X', 'H', 'K', and 'Përfaqja'. The table contains 10 rows of data. Below the table, there is a diagram of a floor plan with a red rectangle highlighting a specific area. The diagram is labeled '252-7' and 'B1-B6'. At the bottom of the form, there are fields for 'Data e dorëzimit', 'Data e miratimit', and 'Data e shpalljes'.

Formati dhe përmbajtja e manualit

Gjithashtu nga të dhënat e fituara nga matjet në terren dhe përpunimi i tyre në zyrë, përgatitet regjistri i ndërtesës. Regjistri i ndërtesës është formati zyrtarë në të cilin paraqiten të dhënat e nevojshme për ndërtesën e cila do të regjistrohet në SIKTK.

Regjistri përmban këto kolona:

- Komuna – *plotësohet emri i komunës në cilën gjendet ndërtesa*
- Zona kadastrale – *plotësohet emri i zonës kadastrale në cilën gjendet ndërtesa*
- Numri i ndërtesës (njësia) – *numri i njësisë së ndërtesës O-71914075-00252-7-____-__*
- Etazhitei – *etazhiteit (katet) që ka ndërtesa*
- Katet – *Bëhet përshkrimi i katit*
- Sipërfaqja e kateve (m²) – *Sipërfaqja e katit*
- Sipërfaqja e bazamentit (m²) – *sipërfaqja e gabaritit të bazamentit të ndërtesës*
- Adresa e njësisë – *emri i rrugës në të cilën ka qasje ndërtesa, të dhënat për adresën mund të merren nga Gjeoportali shtetërorë (<http://geoportali.rks-gov.net>)*
- Vendi i quajtur – *plotësohen të dhënat për vendin e quajtur në të cilin gjendet ndërtesa*
- Shfrytëzimi aktual – *shfrytëzimi aktual i ndërtesës p.sh. shtëpi banimi,*
- Pronari – *emri, emri i prindit dhe mbiemri i pronarit të pronës,*
- Numri personal i pronarit – *numri personal*
- Pjesa e pronësisë – *nëse pronari është i vetëm në pronësi të ndërtesës atëherë plotësohet 1/1*

R E G J I S T R I M I I N D E R T E S E S / S H T E P I S E													
Nr	Komuna	Zona Kadastrale	Numri i ndërtesës (njësia)	Etazhiteti	Katet	Sipërfaqja e kateve	Sipërfaqja e bazamentit [m ²]	Adresa e Njesisë	Vendi i quajtur	Shfrytëzimi i aktual	Pronari Emri (Emri i prindit) Mbiemri	Numri personal	Pjesa e Pronës
1	Prishtinë	Çagllavice	O-71914075-00252-7-____-____	B=P-NK	Bodrumi Përdhesa Nënkulëm	58.82 116.67 113.02	111.67	Rr.Radika	Lugu i thatë	Shtëpi banimi	Genç (Gentrit) Gashi	100100100	1/1


Regjistri i objektit

Numri i njësisë shënohet në këtë format O-71914075-00252-7-____-____, ku pjesa e zbrazët do të plotësohet nga zyrtarët e ZKK-së përkatëse duke u bazuar në numrin e radhës së njësisë.

Në SIKTK-HK për secilën ndërtesë (shtëpi banimi) duhet të azhurnohen edhe gabariti i secilit kate sipas të dhënave që janë cekur në pikën 3 të këtij dokumenti.

5. Njësit banesore / Ndërtesat e kategorisë së dytë

Matja e bazamentit për ndërtesat e kategorisë së dytë behet njëjtë si për kategorinë e parë, konkretisht si përshkrimi në pikën 1 të këtij shpjeguesi.




Formati për ndërtesën dhe pjesët e ndërtesës

Dallimi i vetëm të kategorija e dyte është se për këtë kategori përgatiten të dhënat edhe për njësitë kadastrale pjesë të ndërtesës (banesa, lokale, garazha, depo), ku skicat për njësit banesore si dhe regjistri për pjesë të ndërtesave ndryshon, dhe kanë këtë përmbajtje:

- Pjesa e parë përshkruhen të dhënat për ndërtesën dhe janë këto kolona qe duhet të plotësohen:
 - o Komuna – *plotësohet emri i komunës në cilën gjendet objekti / ndërtesa,*
 - o Zona kadastrale – *plotësohet emri i zonës kadastrale në cilën gjendet objekti / ndërtesa,*
 - o Numri i ndërtesës (njësia) – *numri i njësisë së objektit / ndërtesës O-71914075-00252-7-____-____*
 - o Sipërfaqja (m²) – *sipërfaqja e gabarimit të bazamentit të objektit / ndërtesës,*
 - o Lloji i ndërtesës – *përshkruhet lloji i ndërtesës,*
 - o Adresa e ndërtesës – *emri i rrugës në të cilën ka qasje objekti / ndërtesa, të dhënat për adresën mund të merren nga Gjeoportali shtetëror (<http://geoportali.rks-gov.net>)*
 - o Vendi i quajtur – *plotësohen të dhënat për vendin e quajtur në të cilin gjendet objekti/ndërtesa*
 - o Leja ndërtimore – *Nëse objekti ka leje ndërtimore atëherë kjo fushë plotësohet me numrin e lejes,*
 - o Pronari – *plotësohen të dhënat për pronarin (emri, emri i prindit dhe mbiemri), nëse aplikuesi është biznes atëherë plotësohen të dhënat e kompanisë,*

6. KËRKESË PËR SHERBIMET KADASTRALE NGA GJEODETI APO KOMPANIA GJEODETE E LICENCUAR

Është unifikuar edhe formati i kërkesës së palës që parashtron tek gjodeti apo kompania gjeodete e licencuar


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Strojine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS: KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY
Formulari nr. 5

KËRKESË PËR SHERBIMET KADASTRALE NGA GJEODETI APO KOMPANIA GJEODETE E LICENCUAR

Liqendit / Kompania gjeodete e licencuar:		Numri i licencës:	
Komuna:		Zona Kadastrale:	
Numri i njësive kadastrale:			

1. Të dhënat për parashtruesin e kërkesës

Emri / Emri i kompanisë:	Mbiemri:	Emri i prindit:
Numri personal:	Adresa:	
Numri i biznesit (për person juridik dhe kompani):	Email:	
Nr. Tel:		

2. Parashtruesi i kërkesës: Pronar Shfrytëzues Përfqësues i Autorizuar

3. Lista e dokumenteve të nevojshme:

Pronari/Shfrytëzuesi		Përfqësues i Autorizuar	
<input type="checkbox"/> Letërnjoftim / Certificate biznesi (kopje)	<input type="checkbox"/> Letërnjoftim / Certificate biznesi (kopje)	<input type="checkbox"/> Letërnjoftim / Certificate biznesi (kopje)	<input type="checkbox"/> Letërnjoftim / Certificate biznesi (kopje)
<input type="checkbox"/> Autorizim dhe vërtetim të organit kompetent (kopje)	<input type="checkbox"/> Autorizim dhe vërtetim të organit kompetent (kopje)	<input type="checkbox"/> Autorizim dhe vërtetim të organit kompetent (kopje)	<input type="checkbox"/> Autorizim dhe vërtetim të organit kompetent (kopje)

4. Kërkesa për:

<input type="checkbox"/> Ndërrim të kulturës së parcelës	<input type="checkbox"/> Mënyrë dhe regjistrim të ndërtesës
<input type="checkbox"/> Ndërrim të parcelës	<input type="checkbox"/> Mënyrë dhe regjistrim të pjesës së ndërtesës
<input type="checkbox"/> Bashkim të parcelës	<input type="checkbox"/> Përkrahje të veçanta gjeodetike
<input type="checkbox"/> Përcaktim të kufijve të parcelës	<input type="checkbox"/> Maja e ndërtesës për legalizim
<input type="checkbox"/> R-regullim të kufijve të parcelës	<input type="checkbox"/> R-regullim të kufijve të parcelës

Nënshkrimi: _____
Data: _____

Shtetësi / Nationality: N.N. Numri i licencës: 500
Adresa:

Formati i kërkesës

Në pjesën e poshtme (footer) secili gjeodet apo kompani gjeodete e licencuar duhet të plotësojë me të dhënat e tyre.

Formatet janë përgaditur në formatin dëg dhe janë të strukturuar si më poshtë.

